

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, i përberë nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Vesel Ismaili, me procesmbajtësen Nurije Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit nga fshati Komuna e për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave narkotike, substancave psikotropike ose analoge nga neni 273 par.1 të KPKR-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.63/2018, pas zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor fillestar, publikë e verbal në prezencën e Prokurores së shtetit Ferdane Sylejmani, i akuzuari me mbrojtësin e tij av. nga i angazhuar sipas detyrës zyrtare, më dt.24.05.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

i biri i dhe nënës e gjinisë, i lindur me dt. në tani me vendbanim në fshatin Komuna e, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga dt.15.03.2018 deri me dt.24.05.2018, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

Me datën 14.03.2018, rreth orës 15:20 në i pandehuri ka poseduar me qëllim shitjeje substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 11.3 gram e cila iu është gjetur pas një kontrolli rutinor nga ana e policisë në veturën e tij të tipit "Opell Calibra" me targa të regjistrimit kurse pas bastisjes në banesën dhe në shtëpinë e tij janë gjetur 10.00 gram, dhe 3.1 gram me peshë të përgjithshme prej 22.4 gram, e të cilën Policia e Kosovës e ka konfiskuar.

Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave narkotike, substancave psikotropike ose analoge nga neni 273 par.1 të KPKR-së,

Prandaj gjykata në bazë të nenit 3,4,49,50,51,52,73,74,75,76, dhe nenit 273 par.1 të KPRK-së si dhe në bazë të nenit 359,361,365 dhe nenet 248 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT DHE DËNIM GJOBE

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 3 (tri) viteve i akuzuari nuk do te kryen vepra te tilla, apo çfarë do vepre tjetër penale.

Në rast revokimi të dënimit me kusht ndaj të akuzuarit do ti llogaritet koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga dt.15.03.2018 deri me dt.24.05.2018.

Dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, i cili do ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftëse i akuzuari gjobën e shqiptuar nuk e paguanë në afatin e caktuar, dhe nëse nuk mund të ekzekutohet me detyrim, e njejta do t'i shëndrrohet në dënim burgu, duke ju llogaritur nga 20 (njëzet) Euro për një natë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguan shumë aq sa do të bëhet sipas fletëshpenzimores së kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 (tridhjetë) Euro**, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 183 par. 7 të KPPRK, të akuzuarit [REDAKTUAR] i është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak, dhe i njejti është lëshuar në liri menjëherë.

Konform nenit 62 par. 2 pika 2.7 të KPRK-së ndaj të akuzuarit Mujë Fazliu i shqiptohet:

DËNIM PLOTSUES

Konfiskohet substanca narkotike me peshë të përgjithshme prej 22.4 gram , si mjetë i përdorur për kryerjen e veprës penale.

Urdhërohet shkatërrimi i substancës narkotike nga Policia e Kosovës, sipas procedurave që parasheh ligji.

LIROHET NGA DËNIMI PLOTËSUES

I akuzuari [REDAKTUAR] lirohet nga dënimi plotësues vetëm sa i përket marrjes se sendit (konfiskimit) të automjetit "OPEL KALIBRA" ngjyrë e gjelbërt, me targa [REDAKTUAR]

Automjeti "Opel Kalibra" me karakteristikat të lartë theksuara i kthehet të akuzuarit pasi kanë pushuar shkaqet për të cilat është sekuestruar.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.nr.63/2018 të datës 10.05.2018, e ka akuzuar të pandehurin për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave narkotike, substancave psikotropike ose analoge nga neni 273 par.1 të KPKR-së.

Lidhur me këtë çështjen penale gjykata zhvilloi shqyrtimin gjyqësor fillestar publik e verbal me datën 24.05.2018, dhe pas leximit të aktit akuzues nga Prokurori i shtetit, i akuzuari deklaroi se në tersi e ka kuptuar Aktakuzën, veprën penale për të cilën akuzohet, e në vazhdim thekson se në tersi e ndiejë vetën fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale, këtë vepër penale kam qenë i shtyre ta kryej ngase kushtet ekonomike i kam tejet të rënda, pendohem thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale apo çfarëdo qofshin ato, është hera e parë që kam ra ndeshë me ligjin.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. nga i caktuar sipas detyrës zyrtare thekson: pajtohem plotësisht me pranimin e fajësisë, ngase këtë pranim fajësie e ka bërë duke u konsultuar mjaftueshëm me mua, duke ja sqaruar pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë duke pas parasysh se sot i mbrojturi im e pranoj fajësinë me vullnetin e tij të plotë, duke e kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, e lus gjykatën që t'iu shqipton një dënim më të butë komforë nenit 75 të KPKR-së dhe të ketë parasysh sjelljen korrekte të të mbrojturit tim në gjykatë, pendimin e thellë lidhur me këtë vepër penale, andaj i propozoj gjykatës që të gjitha këto rrethana të ketë parasysh për zbutjen e dënimit, po ashtu i propozoj gjykatës që t'ia ndërpres masën e arrestit shtëpiak duke pasur parasysh se i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe është penduar thellë për veprën penale të kryer dhe se kanë pushuar të gjitha shkaqet për të cilat është caktuar.

Prokurori i Shtetit Ferdane Sylejmani deklaroi: pasi janë plotësuar kushtet ligjore mbi pranimin e fajësisë jepi mendimin dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë ngase i akuzuari ka pranuar akuzën e cila i vihet në barrë, por me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ti vlerësoj rrethanat lehtësuese dhe rënduese duke pasur parasysh edhe pranimin e fajësisë, në seancë fillestare i njëjti në të gjitha fazat e procedurës edhe në fazën hetuese ka pranuar se është kryerës i veprës penale.

Gjykata me rastin e vlerësimit të gjendjes faktike, pasi që i akuzuari në tersi e pranoi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale, fare nuk e zhvilloi procedurën e

administrimit të provave, e as në fjalën përfundimtare të palëve, por të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe i shqiptoi dënim si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi shqiptimin e dënimit, llojit dhe lartësisë së tij, ndaj të akuzuarit mori parasysh rrethanat si ato rënduese gjithashtu edhe ato lehtësuese, në vështrim të nenit 75 të KPRK-së, e si rrethanat rënduese mori parasysh se veprat penale të narkotikëve janë bë dukuri e shpeshtë në shoqërinë tonë, e që rregullisht janë duke pësuar të rinjtë, ndërsa si rrethana lehtësuese ndaj të akuzuarit mori parasysh se është i moshës relativisht të re, pendimin e tij të thellë për kryerjen e veprës penale, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo çfarëdo qofshin ato, se më parë nuk ka qenë i dënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, gjendjen e tij të dobët ekonomike, por si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata mori parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale, andaj bindja e gjykatës është se edhe dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përputhshmëri me shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, atëherë gjykata komfor nenit 75 dhe 76 të KPRK e bëri zbutjen e dënimit ndaj të akuzuarit, duke menduar se edhe me këtë dënim të shqiptuar tek të akuzuari do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve paushallë është marrë në bazë të nenit 450 nënpar.2.6 të KPRK-së.


Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 365 të KPRK u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PKR.nr.120/18 dt.24.05.2018

**Procesmbajtësja
Nuriye Rexhëbeqaj**

**Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari
Vesel Ismaili**



UDHËZIMI JURIDIK:

kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.